



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Konkurs për plotësim të vendeve të lira të punës

Në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shërbyesit Civil nr.03/L-149 dhe Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), fton të interesuarit e kualifikuar të konkurrojnë për vendet e lira të punës. Gjithë procesi i punësimit do të jetë publik dhe transparent.

| | |
|-------------------|--|
| Institucioni: | Agjencia e Kosovës për Akreditim |
| Titulli i postit: | Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim |
| Referenca: | AKA 01/17 |
| Koeficienti: | 8 |
| Kontrata: | I Karrierës |
| Orari i punës: | I Plotë |
| Vendi i punës: | Prishtinë, Qendra e Studentëve, Kati II |
| Raporton te: | Drejtori i AKA-së |

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të institucionit;
2. Të planifikojë, zhvillojë, bashkërendojë dhe zbatojë monitorimin e IAL-ve, sipas legjislacionit në fuqi, në koordinim edhe me institucionet tjera relevante dhe sipas kërkesave të menaxhmentit të AKA-së, si dhe koordinon procesin e monitorimit për plotësimin e rekomandimeve të ekspertëve të akreditimit;
3. Koordinon procesin e vlerësimit të IAL-ve përfshirë organizimin e vizitave në IAL, koordinimin dhe përcjelljen e ekipit të ekspertëve të jashtëm gjatë kohës së vizitës së tyre në institucionet në vlerësim, dërgimin e dokumentacioneve relevante të IAL-ve të cilat janë në proces të vlerësimit/akreditimit;
4. Të ofrojë ndihmën e vet për të gjitha strukturat relevante në AKA lidhur me vlerësimin, informimin, komunikimin dhe publikimin e materialeve për AKA dhe palët e interesit, brenda fushës së veprimit;
5. Të raportojë në mënyrë të rregullt ose periodike tek menaxhmenti i AKA-së, sipas nevojës dhe kërkesës, për të gjitha rezultatet dhe gjetjet eventuale në funksionimin e IAL-ve, që janë kompetencë e AKA-se dhe pozitës gjegjëse;

6. Kontrollon dhe vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga IAL-të lidhur me procesin e akreditimit, vlerësimit dhe monitorimit, nëse është në përputhje me kërkesat dhe standardet e AKA-së;
7. Komunikon me zyrtarët përgjegjës të IAL-ve dhe palët e interesuara, lidhur me procesin e akreditimit, vlerësimit dhe monitorimit;
8. Të kryej edhe punët e tjera sipas nevojës së AKA-së, në përputhje me rregullativën në fuqi dhe me kërkesat e Drejtorit;

Kualifikimi dhe përvoja:

1. Diplomë universitare nga fusha e edukimit, shkencave sociale ose fushave tjera relevante;
2. Së paku 3 vite përvojë pune profesionale në fushën relevante;
3. Njohuri profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
4. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
5. Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
6. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
7. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
8. Kërkohe aftësi të shkëlqyera të zotërimit të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze në shkrim dhe në të folur; preferohet njohja e mirë e gjuhës serbe dhe ndonjë gjuhë tjetër të huaj;

Kandidatët duhet të sjellin dëshmitë e më poshtme me rastin e aplikimit:

1. Kualifikimin shkollor (diploma të jetë e vërtetuar te noteri)
2. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit të jetë e nostrifikuar
3. Vërtetim mbi përvojën e punës dhe pasqyrën nga trusti pensional
4. Certifikata që nuk jeni nën hetime
5. Dokumentin e identifikimit.

Shërbimi Civil i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kandidatët e interesuar me rastin e konkurimit duhet të sjellin dëshmi (vërtetim) për përvojën e punës. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurim) mund ta shkarkojnë [këtu](#), ose ta marrin në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Adresa: Rr. “Agim Ramadani” Qendra e Studentëve, kati i dytë ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në gazetë. Dita e fundit për dorëzim të aplikacioneve është 14.04.2017.